



Republika e Kosovës  
Republika Kosova -Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS  
DHE E TEKNOLOGJISË



## **SHPALLJE**

# **Bursat e hyrjes për studentët nga Kosova në Universitetin e Sheffield-it, fakultetin ndërkombëtar "CITY College", 2018-2019**

Për:

- **Studime universitare (Bachelor)**
- **Studime pasuniversitare (Master-me orar të plotë)**
- **MBA-ekzekutive (me orar jo të plotë)**
- **Diploma kërkimore (me orar të plotë PhD)**

Universiteti i Sheffield-it, fakulteti ndërkombëtar "CITY College" në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, ofrojnë gjashtëdhjetë e dy (62) bursa për studentë nga Kosova për studime Bachelor, Master (me orar të plotë), MBA (me orar jo të plotë) dhe diploma kërkimore (me orar të plotë) (Viti i pranimit: 2018-2019). Sipas kësaj iniciative, "CITY College", synon të mbështesë shkollimin për studentët e dalluar të cilët dëshirojnë të studiojnë në "CITY College" në Selanik-Greqi dhe të marrin diplomë të pranuar në nivel ndërkombëtar nga Universiteti i Sheffield-it. Studimet do të ofrohen në kampusin e Universitetit të Sheffield-it, "CITY College" në Selanik.

Universiteti i Sheffield-it është universitet me renome, ndër më të mirët në Britaninë e Madhe, që vazhdimisht radhitet në mesin e "100 universiteteve më të mira në botë", në "top 10% e universiteteve më të mira për kapacitete hulumtuese". Zë vend në 1% -shin e "Universiteteve më të mira në botë". Ky është një institucion i kryesuar nga kërkimet shkencore, me një reputacion botëror për cilësinë dhe gjashtë fitues të Çmimit Nobel.

Për më shumë informata në lidhje me programet e fakultetit ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield-it, CITY College, luteni të vizitoni [citycollege.sheffield.eu](http://citycollege.sheffield.eu)

## **Bursa për studime universitare (Bachelor)**

**Dhjetë (10) bursa të plota për studime universitare** (për 3 vite studimi), sipas skemës në vijim:

- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (4,120 € për student për një vit);
- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT-i (4,120 € për student për një vit).

**Dhjetë (10) bursa me gjysmë tarife të shkollimit për studime universitare** (për 3 vite studimi), sipas skemës në vijim:

- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (4120 € për student për një vit);
- 50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studentët (4120 € për student për një vit).

Studimet Bachelor zgjasin 3 vite dhe bursat janë në dispozicion për programet në vijim:

### **Administrim Biznesi & Departamenti i Ekonomisë**

- BA (Hons) në Studime Biznesi (Marketing)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Menaxhment)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Kontabilitet & Financë)
- BA (Hons) në Studime Biznesi (Hotele dhe Mikpritje)

### **Departamenti i Shkencave Kompjuterike**

- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Informatikë Biznesi)
- BSc (Hons) në Shkenca Kompjuterike (Informatikë në Internet)

### **Departamenti i Psikologjisë**

- BSc (Hons) në Psikologji

### **Departamenti i Studimeve të gjuhës angleze**

- BA (Hons) në Mësimdhënie të gjuhës angleze dhe gjuhësi

### **SHËNIM I RËNDËSISHËM:**

Përfituesit e bursave do të jetojnë në Selanik gjatë studimeve të tyre.

## **PËRSHTATSHMËRIA PËR BURSAT BACHELOR**

Kandidatët për bursat Bachelor duhet të plotësojnë kërkesat e pranimit të Fakultetit Ndërkombëtar për programet e "CITY College" për të cilat ata aplikojnë.

Kandidatët që kanë të drejtë për programet universitare duhet të mbajnë një Certifikatë për mbarimin e Shkollës së Lartë (Matura dhe të kenë arritur pikat për regjistrim në universitet në bazë të Ligjit) me performancë të mirë. Kandidatët që nuk posedojnë ende këtë certifikatë gjatë kohës së aplikimit për bursë, duhet të sjellin kopje të certifikara të gjitha certifikatave të notave gjatë tre viteve të fundit (të përkthyer në gjuhën Angleze).

Ata poashtu duhet të kenë një njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze (TOEFL: 79 ose IELTS bazuar në internet: 6,0 ose kualifikime ekuivalente). Kandidatët që nuk posedojnë në kohën e aplikimit ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të mësipërme, kanë të drejtë për bursa me kusht që ata të hyjnë në testin e gjuhës angleze që do të organizohet nga Universiteti i Kosovës (shiko: **Testin e gjuhës angleze** më poshtë\*).

Nxënësit që kanë përfunduar studimet e tyre të shkollës mesme / të lartë përmes mediumit të gjuhës angleze, gjithashtu duhet të paraqesin një kualifikim të gjuhës angleze ose të hyjnë në testin e gjuhës angleze, që do të organizohet në Prishtinë nga Universiteti (shih **Testin e gjuhës angleze** më poshtë\*).

**Për detaje të plota të kërkesave për pranim dhe aplikim lexoni linkun më poshtë**

[Admission Requirements for Bachelors programmes](#)

[Application form for Bachelors programmes](#)

## **Bursa për studime pasuniversitare (Master me orar të plotë)**

**Dhjetë (10) bursa të plota për studime pasuniversitare me orar të plotë** (1 vit studimesh), sipas skemës në vijim:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (5,340 € për student);

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT-i (5,340 € për student).

**Pesëmbëdhjetë (15) bursa me gjysmë tarife të shkollimit për studime pasuniversitare me orar të plotë** (1 vit studimi), sipas skemës në vijim:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (5,340 € për student);

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studentët (5,340 € për student).

Studimet Master zgjasin 1 vit (programi me orar të plotë) dhe mbahen gjatë ditëve të javës (e hënë - e premte), përveç "MA në gjuhësi të aplikuar dhe TESOL". "MA në gjuhësi të aplikuar me TESOL" është gjithashtu me kohë të plotë, por mësimi mbahet gjatë fundjavave.

Bursat janë në dispozicion për programet në vijim:

### **Administrim Biznesi & Departamenti i Ekonomisë**

- MSc në Banka & Financa
- MSc në Menaxhment
- MSc në Menaxhment (Menaxhim i Burimeve Njerëzore)
- MSc në Menaxhment (Logjistikë dhe Menaxhim i Zinxhirit të Furnizimit)
- MSc në Hotele & Menaxhim të Turizmit
- MA në Marketing, Reklama & Marrëdhënie me Publikun
- MA në Marketing Digjital dhe Media Sociale

### **Departamenti i Shkencave Kompjuterike**

- MSc në Inxhinieri Softuerike të avancuar (Rrjetet e të dhënave)
- MSc në Inxhinieri Softuerike të avancuar (Aplikacionet në internet dhe celular)
- MSc në Inxhinieri Softuerike të avancuar (Siguria e informacionit)

### **Departamenti i Psikologjisë**

- MSc në Psikologji këshillimi
- MSc në Neuropsikologji kognitive

### **Departamenti i Studimeve të gjuhës angleze**

- MA në gjuhësinë e aplikuar dhe TESOL (mbahet gjatë vikendeve)

### SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Përfituesit e bursave të të gjitha programeve Master (ku mësimi mbahet gjatë ditëve të javës) priten të jetojnë në Selanik gjatë studimeve të tyre. Megjithatë, studiuesit për MA në Gjuhësinë e Aplikuar dhe TESOL të Departamentit të Studimeve Angleze ndjekin mësimet në fundjava specifike dhe mund të zgjedhin të udhëtojnë në Selanik për mësimet e fundjavës.

### **PËRSHTATSHMËRIA PËR BURSAT MASTER**

Kandidatët për bursat Master duhet të plotësojnë kërkesat e pranimit të programeve të fakultetit ndërkombëtar, "CITY College" për të cilat ata aplikojnë.

Kandidatët e pranuar për programet pasuniversitare normalisht priten që të posdojnë ose të arrijnë një diplomë të mirë Honours Class nga një universitet ose një kolegji i akredituar sipas ligjit të Kosovës.

Ata duhet të kenë njohje të shkëlqyeshme të gjuhës angleze (TOEFL: 89 ose IELTS bazuar në internet: 6,5 ose CAE (A ose B) ose kualifikime ekuivalente). Kandidatët që nuk posedojnë në kohën e aplikimit ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të mësipërme kanë të drejtë për bursa me kusht që ata të hyjnë në testin e gjuhës angleze, që do të organizohet në Prishtinë nga Universiteti (shiko: **Testin e gjuhës angleze** më poshtë\*). Studentët që kanë përfunduar studimet e tyre universitare (Bachelor) përmes mediumit të gjuhës angleze nuk janë të detyruar të paraqesin kualifikimin e gjuhës angleze.

**Për detajet e plota të kërkesave për pranim dhe aplikim lexoni linkun më poshtë**

[Admission requirements for postgraduate studies \(MA & MSc programmes\) \(pdf\)](#)

Ju mund të shkarkoni formularin e aplikimit për studime Master në linkun e mëposhtëm:

[Application form for MA and MSc programmes \(pdf\)](#)

## **Bursa për programin ekzekutiv MBA – në dispozicion për punonjësit e sektorit publik dhe privat**

**Dhjetë (10) bursa të plota për MBA për të punësuarit në sektorin publik dhe privat** duke përjashtuar punonjësit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas skemës së mëposhtme:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (7,445 € për student);

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT (7,445 € për student).

**Pesë (5) bursa MBA me gjysmë tarifë të shkollimit për të punësuarit në sektorin publik dhe privat** duke përjashtuar punonjësit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas skemës së mëposhtme:

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (7,445 € për student);

50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga studentët (7,445 € për student).

Bursat janë në dispozicion për specializimet në programet Ekzekutive MBA (EMBA):

- MBA në Menaxhment të përgjithshëm
- MBA në Marketing
- MBA në Financa
- MBA në Logjistikë
- MBA në Menaxhim i kujdesit shëndetësor
- MBA në Menaxhimin e burimeve njerëzore

Shënim i rëndësishëm:

- MBA Ekzekutive është një program me kohë të pjesshme, që zgjat 2 vjet dhe klasat mbahen në Selanik gjatë një fundjave në muaj.
- Përfituesit e bursave priten që të udhëtojnë për në Selanik gjatë fundjavave të caktuara sipas orarit për programet MBA
- Përfituesit e bursave priten të udhëtojnë për në Sheffield, në Mbretërinë e Bashkuar për një javë në fund të vitit të parë të studimeve. Shpenzimet e udhëtimit për në Sheffield, në Mbretërinë e Bashkuar do të mbulohen nga studenti.

## **PËRSHTATSHMËRIA PËR BURSAT MBA**

Kandidatët për bursat MBA duhet të plotësojnë kërkesat e pranimit të programeve të fakultetit ndërkombëtar, "CITY College" për të cilat ata aplikojnë.

Kandidatët e pranueshëm për programet MBA ekzekutive priten që të posdojnë ose të arrijnë një diplomë të mirë Honors Class nga një universitet ose një kolegji i akredituar sipas ligjit të Kosovës.

Ata duhet të kenë njohje të shkëlqyeshme të gjuhës angleze (TOEFL: 89 bazuar në internet ose IELTS: 6,5 ose kualifikime ekuivalente). Kandidatët që nuk posedojnë në kohën e aplikimit ndonjë nga kualifikimet e gjuhës angleze të mësipërme, kanë të drejtë për bursa me kusht që ata të hyjnë në testin e gjuhës angleze, që do të organizohet në Prishtinë nga Universiteti (shiko: **Testin e gjuhës angleze** më poshtë\*). Studentët që kanë përfunduar studimet e tyre universitare (Bachelor) ose pasuniversitare (Master) përmes mediumit të gjuhës angleze nuk janë të detyruar të paraqesin një kualifikim të gjuhës angleze.

Mosha minimale e kërkuar është 26 dhe nevojitet certifikimi i përvojës së punës. Kandidatët që punojnë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk kanë të drejtë për bursa MBA.

### **Për detajet e plota të kërkesave për pranim dhe aplikim lexoni linkun më poshtë**

[Admission requirements for the Executive MBA programme \(pdf\)](#)

Ju mund të shkarkoni formularin e aplikimit për MBA ekzekutive në linkun e mëposhtëm

[Application form for the Executive MBA programme \(pdf\)](#)

## **Bursat për Diploma Hulumtuese (PhD)**

**Dy (2) bursa për studime (PhD) me orar të plotë ose të pjesshëm** në Qendra Kërkimore për Evropën Juglindore (SEERC) sipas skemës në vijim:  
50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga universiteti (7,500 funta britanikë në vit për student për 3 vjet)  
50% e pagesave të studimit do të mbulohen nga MASHT (7,500 funta britanikë në vit për student për 3 vjet )

Në përgjithësi, hulumtimi në Qendrën e Kërkimit për Evropën Juglindore (SEERC) trajton tri fusha të gjera::

- Ndërmarrësia, inovacioni dhe zhvillimi i biznesit dhe ekonomisë
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
- Shoqëria dhe zhvillimi njerëzor: Psikologji, Politikë, Sociologji dhe Arsim.

## **PËRSHTATSHMËRIA PËR BURSAT PhD**

Kandidatët për bursat PhD duhet të plotësojnë kërkesat e pranimit të programeve të fakultetit ndërkombëtar, "CITY College" për të cilat ata aplikojnë.

Kandidatët e përshtatshëm për studimet PhD, normalisht priten të kenë diplomën e parë të mirë (Klasa 2.1 ose më lart) dhe një kualifikim të nivelit master në fushën përkatëse. Kandidati duhet të ketë një njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze. Kërkesat e gjuhës angleze ndryshojnë, varësisht nga Departamenti i regjistrimit. Ju lutemi shihni kërkesat e gjuhës angleze për studentët hulumtues të ardhshëm në Universitetin e Sheffield në linqet e mëposhtme:

<http://www.sheffield.ac.uk/postgraduate/research/englang>

<http://www.sheffield.ac.uk/postgraduate/info/englang>

Ju lutem të keni parasysh se posedimi i diplomës nga një Universitet që zhvillon mësimin në gjuhën Angleze nuk ju garanton përmbushjen e kriterëve të gjuhës angleze. Për pyetje shtesë mund të kontaktoni:

[phd\\_admissions@seerc.org](mailto:phd_admissions@seerc.org)

Kandidati pritet gjithashtu të jetë entuziast, punëtor i zellshëm, mirë i organizuar dhe i aftë për t'u dhënë përparësi kërkesave të punës. Përvoja e mëparshme kërkimore konsiderohet si avantazh.

**Për detajet e plota të thirrjes për aplikim të bursave PhD, lexoni linkun e mëposhtëm:**

[Call for PhD Applications from Kosovo 2018-2019](#)

[More about the South East European Research Centre \(SEERC\).](#)

Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim rreth bursave PhD, ju mund të shkruani tek: [phd\\_admissions@seerc.org](mailto:phd_admissions@seerc.org)

### **\*Testi i gjuhës angleze**

Kriteret për njohjen e gjuhës angleze janë cekur qartë në seksionet përkatëse të përshtatshme të përmendura më lart. Të gjithë kandidatët të cilët nuk posedojnë ndonjë prej kualifikimeve të gjuhës angleze të përcaktuara me kriteret e universitetit do t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze. Testi do të organizohet dhe mbikëqyret nga përfaqësuesit e fakultetit ndërkombëtar të universitetit të Sheffield, CITY College.

Testi i gjuhës angleze do të mbahet në Prishtinë, të Shtunën më 23 qershor 2018 dhe vendi i testit do të shpallet më vonë.



Kandidatët të cilët posedojnë ndonjë kualifikim të gjuhës angleze dhe nuk janë të sigurtë në vlefshmërinë e saj, duhet ta kontaktojnë z. Gregory Dikaios në [gdikaios@citycollege.sheffield.eu](mailto:gdikaios@citycollege.sheffield.eu) për të verifikuar nëse kualifikimi i tyre është i pranueshëm nga universiteti.

### **Intervista**

Të gjithë aplikuesve për bursa Bachelor, Master dhe MBA do t'ju kërkohet të marrin pjesë në një intervistë personale si pjesë e procedurës së përzgjedhjes. Intervista do të zhvillohet në Prishtinë nga një përfaqësues i fakultetit ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield, "CITY College".

Intervistat do të zhvillohen në Prishtinë ndërmjet 20 Qershorit (e Mërkurë) dhe 24 Qershorit (e Diel). Vendi për intervistat do të shpallet më vonë.

Aplikuesit për bursa PhD do të intervistohen veçmas nga një përfaqësues i Qendrës për Hulumtime të Evropës Juglindore (SEERC) në shtator të vitit 2018 dhe data e saktë do të shpallet në kohën e duhur.

### **Procesi i përzgjedhjes**

Fakulteti ndërkombëtar i universitetit të Sheffield, "CITY College" është përgjegjës për procesin e përzgjedhjes. Procesi i përzgjedhjes do të ekzekutohet nga fakulteti ndërkombëtar në bazë të kërkesave të pranimit të saj dhe rregulloreve.

### **SI TË APLIKONI?**

Kandidatët e interesuar për bursat e lartpërmendura duhet t'i plotësojnë dhe t'i sjellin aplikacionet e tyre në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në zyrën e përmendur më poshtë (shiko linqet më lartë). Së bashku me formularin e aplikimit, kandidatët gjithashtu duhet të dorëzojnë edhe të gjitha dëshmitë e kërkuara për kualifikim akademik (kopje të origjinaleve si dhe përkthimin zyrtar në gjuhën angleze, të gjitha të certifikuara si kopje të mirëfillta) siç është specifikuar në kriteret për pranim dhe aplikim në linqet më lartë.

#### Vërejtje:

Ata që nuk kanë diplomuar akoma, mirëpo pritet të diplomojnë deri më 15 Shtator 2018, duhet t'i dorëzojnë të gjitha certifikatat e notave që i kanë në dispozicion deri më tani. Komisioni i bursave do të vendosë duke u bazuar në dëshmitë akademike në dispozicion në ditën e përzgjedhjes. Rezultati i testit të maturës apo diploma e universitetit/kolegjit duhet të dorëzohen menjëherë pasi të jenë lëshuar. Për hollësi, luteni të shikoni kriteret relevante për pranim dhe aplikim të Universitetit të Sheffield-it në linqet më lartë.

## **Dorëzimi i aplikacionit tuaj për bursë**

Aplikacionet për bursa dhe të gjitha dokumentet relevante duhet të futen në një zarf dhe të dorëzohen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë në këtë adresë:

### **Znj. Kumrije Gagica**

Zyra e protokollit

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

E-mail: [kumrije.gagica@rks-gov.net](mailto:kumrije.gagica@rks-gov.net)

## **Procesi i përzgjedhjes për bursistët**

1. Aplikacionet do të dorëzohen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës në zarf. Sigurohuni që të shkruani emrin, telefonin dhe postën elektronike në zarf.
2. Kandidatët pa kualifikimin e kërkuar të gjuhës angleze do të hyjnë në testin e gjuhës angleze. Testi do të organizohet në Prishtinë nga universiteti.
3. Kandidatët për bursa do të ftohen për intervistë.
4. Aplikacionet do të shqyrtohen nga Departamentet Akadematike në fakultetin ndërkombëtar të Universitetit të Sheffield, "CITY College" në Selanik.
5. Lista përfundimtare e bursistëve do të vendoset nga Komisioni i Bursave në Universitet
6. Rezultatet do të shpallen zyrtarisht në ueb-faqen e Ministrisë dhe të Universitetit.
7. Të gjithë kandidatët do të informohen me kohë përmes postës elektronike.

Për më shumë informata lidhur me bursat, ju lutemi kontaktoni përfaqësuesen e fakultetit ndërkombëtar të universitetit Sheffield "CITY College" në Prishtinë:

Znj. Hana Hoxha

[hoxha@citycollege.sheffield.eu](mailto:hoxha@citycollege.sheffield.eu)

### **Kushtet shtesë**

Bursa mbulon tarifat e shkollimit, qasjen në bibliotekë dhe tarifat e regjistrimit. Prandaj studentët duhet të mbulojnë me financat e tyre udhëtimin, strehimin dhe shpenzimet e tyre të jetesës.

Nëse një student-marrës i një burse nuk merr pjesë në program për ndonjë arsye personale ose ndonjë arsye tjetër, atëherë një student nga lista e dytë do ta zëvendësojë atë, duke përfshirë studentët me vetëfinancim prej 50%.

MASHT-i dhe universiteti do të bien dakord për zëvendësimet e studentëve edhe në raste të tjera, ku zgjedhja e studentëve do të bëhet nga universiteti.

Nëse një bursist, për shkaqe shëndetësore ose arsye të tjera urgjente, kërkon pezullim të përkohshëm të studimeve, MASHT do të krijojë një komision për të verifikuar kërkesën për pezullim: Komiteti do ta miratojë ose refuzojë kërkesën në bazë të fakteve.

Rastet kur paraqitja e diplomës është në pritje, bursistët do të jenë të detyruar të paraqesin certifikatën e diplomës ose diplomën, më së voni deri më 15 Shtator 2018, përndryshe ata do të zëvendësohen nga studentët në listat e radhës, duke përfshirë studentët me vetëfinancim prej 50%.

### **Kushtet tjera**

1. Universiteti i Sheffield-it, fakulteti ndërkombëtar duhet ti ofrojë MASHT-it informacion në lidhje me progresin e bursistëve. Në veçanti rreth:
  - a) Regjistrimit të rregullt të studentëve dhe përfundimit të suksesshëm të vitit akademik (informacioni duhet t'i ofrohet MASHT-it dy herë për secilin vit akademik.
  - b) Për ndonjë bursist i cili tërhiqet nga studimet e tyre
2. MASHT-i dhe universiteti i Sheffield-it, fakulteti ndërkombëtar janë dakord se studentët që dështojnë vitin e tyre akademik do të humbasin të drejtën e tyre për bursa.
3. Bursistët do të nënshkruajnë një kontratë studimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria.

### **Datat e rëndësishme për vështrim**

#### **Për Bursat Bachelor, Master, dhe MBA:**

Afati kohor për aplikimi	13 Qershor 2018 (E Mërkurë)
Vetëm intervistat për Bursat Bachelor, Master, dhe MBA	20-24 Qershor 2018
Testi i gjuhës angleze	23 Qershor 2018 (E Shtunë)
Shpallja e rezultateve për Bursat Bachelor, Master dhe MBA	Pritet të shpallet

#### **Për bursat kërkimore (PhD):**

Afati kohor për aplikim	29 Qershor 2018 (E premte)
Intervistat për Bursat PhD	Shtator 2018
Rezultatet për bursa kërkimore (PhD)	Pritet të shpallen